



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
SHOQERIA "LIM - EM" SH.P.K

## KONTRATE DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

(Lloji kuota)

Sot me date 21.04.2017 (dymije e shtatembedhjete), ne palet e meposhtme redaktojme kete kontrate dhurimi kuotash si me poshte vijon:

### PALA DHURUESE:

**Z. SHKËLQIM BESHIRI**, i biri i Liman-it, i datëlindjes 22.08.1966, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, Rruga " Gjergj Legisi", Nr. 2, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i Pasaportes Nr. SE6102016, me numer personal G60822041V (më poshtë i quajtur "Dhuruesi").

### PALA PERFITUESE E DHURIMIT:

**Z. ARDIAN BESHIRI**, i biri i Liman-it, i datëlindjes 13.05.1971, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar nepermjet leternjoftimit Nr. 027689604 dhe me numer personal H10513184V (më poshtë i quajtur "perfituesi i dhurimit").

Dhuruesi dhe Perfituesi i dhurimit, referuar të dy së bashku do të quhen "Palët".

### Të përgjithshme

1. Dhuruesi është zotërues i 100 (njqind) kuotave, me vlere 958,000,000.00 (*nenteqind e pesedhejte e tete milion*) Leke, qe perben **100 (njqind) %** te kapitalit të Shoqërisë "LIM-EM" shpk, me seli ne TIRANE, Njesia Nr. 2, Rruga "Budi", Pallati "Fasked", kati i 2<sup>te</sup>. (më poshtë referuar si shoqëria.)
2. Shoqëria është rregjistruar pranë QKR-se si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e pajisur me **NUIS K222180050**, me objekt kryesor "*Prodhim e tregetim me shumice e pakice te materialeve te ndertimit, inerte, rere, gure, zhavor, blloqe betoni, parafabrikate, aktivitet ne fushen e ndertimit. Aktivitet minerar dhe pune me lende plasese te perdorimit civil, ofrimin e sherbime te konsulences ligjore dhe fushes se avokatisë.*".
3. Shoqëria "LIM-EM" Sh.p.k zotërohet nga nje ortak i vetem.

### Neni 1

#### Objekti

Në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kontrate, Dhuruesi i kalon perfituesit te dhurimit 50% te kuotave, qe perben 50 % të kapitalit të zotëruar në kete shoqëri, me vlere 479,000,000.00

(katerqind e shtatedhejte e nente milion) Leke pa asnje kundershperblim si dhe të drejtat e tjera të lidhura me këtë pjesëmarrje duke e garantuar plotësisht per titullin e pronësisë. Perfituesi i Dhurimit, pranon dhurimin dhe kalimin e pronesise se kuotave pa asnje kundershperblim duke qene mirnjohes ndaj dhuruesit.

## Neni 2

### Kalimi i pronësisë mbi kuotat

Kalimi i pronësisë mbi kuotat nga Dhuruesi te perfituesi i Dhurimit do të kryhet menjëherë me nënshkrimin e kontratës.

## Neni 3

### Garancitë

Dhuruesi në lidhje me kuotat që zotëron, garanton perfituesin e dhurimit se :

1. Është pronar i vetem i kuotave të dhuruara. Në rast të kundërt pala dhuruese merr përsipër personalisht zgjidhjen e çdo lloj konflikti.
2. Në të njëjtën kohë, pala dhuruese merr përsipër, garanton dhe siguron palën perfituese te dhurimit se sot në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate kuotat objekt dhurimi:
  - Janë te lira nga çdo barrë, marrëveshje apo vendim tjetër kufizues;
  - Nuk janë objekt i ndonjë konflikti gjyqësor;
  - Janë te lira nga çdo e drejtë apo pretendim i personave të tretë;
  - Nuk jane objekt i pretendimeve nga asnjë zyrë përmbarimi, shtetërore dhe/ose private.

## Neni 4

### Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës se Shqipërisë, Ligji “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” si dhe dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.



## Neni 5

### Regjistrimi

- Kjo kontratë duhet të regjistrohet pranë QKR-së në bazë të nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.
- Pas nënshkrimit të kësaj kontrate shoqëria “LIM -EM” Sh.p.k do të ketë dy ortakë si me poshte :
  - b. Z. Shkëlqim Beqiri, zoterues i 50(pesedhjete) kuota qe perbejne 50% te kapitalit themeltar
  - a. Z. Ardian Beshiri zoterues i 50(pesedhjete) kuota qe perbejne 50% te kapitalit themeltar
- Personi që kalon kuotat dhe ai që i fiton ato, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave, nga Çasti i kalimit të kuotave deri në Çastin e regjistrimit të kalimit sipas dispozitave në fuqi.

## Neni 6

---



## Shpenzimet

Të gjitha taksat, tatimet si dhe shpenzimet që kanë lidhje me këtë kontratë do të paguhen nga pala përkatëse sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar. Palët në këtë kontratë nuk mund ti kërkojnë njëra tjetrës uljen/ngritjen e çmimit të shitjes për shkak të shpenzimeve të sipërpëmendura.

## Neni 7

### Interpretimi i Kontratës

Çdo kusht apo formulim që mund të shkaktojë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët në lidhjen e kësaj kontrate.

Për çfarë nuk është parashikuar në këtë kontratë, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

## Neni 8

### Njoftimi zyrtar midis palëve

Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim ndërmje palëve do të bëhet në formë të shkruar dhe në adresat e përshkruara në këtë kontratë.

## Neni 9

### Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi apo zbatimi i kushteve të kësaj kontrate, do të zgjidhet me bisedim dhe mirëkuptim të ndërsjellë midis palëve dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e konfliktit do të jete *Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane*.

## Neni 10

### Hartimi i Kontratës

Kjo kontratë hartohet në kater njësi origjinale të cilat kanë të njëjtën përmbajtje dhe vlerë ligjore, prej të cilave nga 3 njësi i mbajnë palët dhe një njësi depozitohet pranë QKR-së .

Ne Palët deklarojme se kuptojme dhe se e pranojmë këtë kontratë, pasi ajo është në përputhje me vullnetin tone të lirë dhe të plotë dhe e nënshkruajmë atë rregullisht.

## PALET KONTRAKTUESE

DHURUESI

PERFITUESI I DHURIMIT

*Shkelqim Besiri*

*Flaudrian Besiri*



